



RILINDJA
GJELBËR

EKONOMIA QARKORE DHE TRANZICIONI I GJELBËR NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

MAJ 2026



Ky publikim është zbatuar nga Rilindja Gjellbër, menaxhuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) dhe prodhurar me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze në Prishtinë. Përmbajtja e tij rrjedh nga përgjigjet e anketave të marra deri në datën e specifikuar në këtë raport dhe është përgjegjësi e vetme e Rilindja Gjellbër, zbatues i projektit “Kthimi i Vlerave në Ekonominë Qarkore” nën kuadrin e programit “Fuqizimi i OSHC-ve Mjedisore në Kosovë.

EKONOMIA QARKORE DHE TRANZICIONI I GJELBËR NË INDUSTRINË E TEKSTILIT

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

MAJ, 2026

PËRMBAJTJA

Hyrje	9
Metodologjia	10
Rezultatet e Studimit	11
Analiza e Politikave	11
Profili i Industrisë së Tekstilit	15
Furnizimi me Produkte të Tekstilit	16
Menaxhimi i Mbeturinave të Tekstilit.....	22
Njohuritë dhe Ndërgjegjësimi	28
Zbatimi i Ekonomisë Qarkore.....	29
Ndryshimet Klimatike dhe Gjurma e Karbonit.....	30
Interesimi dhe Sfidat për Riciklim dhe Ripërdorim.....	30
Konkluzione dhe Rekomandime.....	34

LISTA E SHKURTESAVE

CDF – Community Development Fund

AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

GIZ – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

USAID – United States Agency for International Development

BE – Bashkimi Evropian

SAA – Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit

CEFTA – Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore

EPR – Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Kategorizimi i bizneseve.....	15
Figura 2. Llojet e aktiviteteve të bizneseve	16
Figura 3. Eksporti dhe importi i produkteve të tekstilit sipas kategorive kryesore për vitin 2025	17
Figura 4. Eksporti dhe importi i veshjeve të përdorura për vitin 2025	18
Figura 5. Vlera e mallrave sipas kategorive për vitin 2025.....	19
Figura 6. Çfarë lloji të produkteve të mëposhtme të tekstilit blini - veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë).....	20
Figura 7. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? (Pyetje e shumëfishtë)	20
Figura 8. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? Krahasimi 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë).....	21
Figura 9. Cila është lënda e parë që përdorni për produktet e prodhuara? (Pyetje e shumëfishtë)	22
Figura 10. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesoret/produktet e tekstilit shtëpiak që nuk i përdorni më? (Pyetje e shumëfishtë)	23
Figura 11. Përafërsisht sa kilogram veshmbathje i hidhni gjatë një viti?	23
Figura 12. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? (Pyetje e shumëfishtë).....	25
Figura 13. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? Krahasimi 2024-2025 (Pyetje e shumëfishtë).....	25
Figura 14. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës?	26
Figura 15. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës? Krahasimi 2024-2025.....	27
Figura 12. Cili mendoni se është shkaku kryesor i mos informimit tuaj mbi këtë çështje? (Pyetje e shumëfishtë).....	28
Figura 13. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore?	29
Figura 18. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore? Krahasimi 2024-2025	30
Figura 19. Nëse jo, pse nuk jeni të përfshirë?	31


Figura 20. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve?	32
Figura 21. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve? Krahasimi 2024-2025 .32	
Figura 22. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit.....	33
Figura 23. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit. Krahasimi 2024-2025.....	33

HYRJE

Industria e tekstilit dhe veshjeve në Kosovë vazhdon të përfaqësojë një sektor me rëndësi për zhvillimin ekonomik, punësimin dhe potencialin për transformim të qëndrueshëm. Në një kontekst ku ekonomia qarkore po merr gjithnjë e më shumë vëmendje në politikat publike, tregjet evropiane dhe praktikatat e biznesit, sektori i tekstilit paraqet një fushë të rëndësishme për ndërhyrje, pasi lidhet drejtpërdrejt me prodhimin, konsumin, ripërdorimin, riciklimin dhe menaxhimin e mbeturinave.

Ky raport është realizuar si pjesë e vlerësimit vjetor për vitin 2025 në kuadër të projektit “Kthimi i Vlerave në Ekonominë Qarkore”, i zbatuar nga Rilindja e Gjellbër përmes programit “Fuqizimi i OSHC-ve Mjedisore në Kosovë”, menaxhuar nga Community Development Fund (CDF) dhe i mbështetur financiarisht nga Ambasada Suedeze në Prishtinë. Raporti ndërtohet mbi bazën e vlerësimit të vitit 2024, por është përshtatur për të pasqyruar zhvillimet, të dhënat dhe gjetjet e vitit 2025, duke përfshirë edhe krahasime ndërmjet dy viteve aty ku të dhënat janë të krahasueshme.

Qëllimi kryesor i raportit është të ofrojë një pasqyrë të gjendjes aktuale të sektorit dhe të identifikojë mundësitë për kalimin nga modeli linear “merre-prodho-hidhe” drejt një modeli më qarkor, ku produktet dhe materialet mbahen më gjatë në përdorim përmes ripërdorimit, riparimit, riciklimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në këtë drejtim, raporti shqyrton ciklin e produkteve të tekstilit në Kosovë, nga importi dhe prodhimi deri te përdorimi dhe menaxhimi pas përdorimit, duke kombinuar të dhëna nga qytetarët, bizneset dhe politikbërësit për të identifikuar progresin, sfidat dhe hapat e nevojshëm për një sektor më të qëndrueshëm.



METODOLOGJIA

Qasja metodologjike për realizimin e vlerësimit vjetor të industrisë së tekstilit dhe praktikave të menaxhimit të mbeturinave të tekstilit në Kosovë gjatë vitit 2025 ka qenë e kombinuar, duke përfshirë:

Rishikim të dokumenteve strategjike, legjislativë dhe literaturë shtesë.	Analizë të të dhënave sekondare nga Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës	Anketë me 400 qytetarë të moshës mbi 18 në të gjitha komunat e Kosovës.	Intervista me 100 biznese nga sektori i tekstilit, nga vende të ndryshme të Kosovës.	Intervista me katër (4) përfaqësues institucionalë/politikbërës kyç.
---	---	--	---	---

Metodat e kërkimit kanë kombinuar qasjen sasiore dhe cilësore, me qëllim që të sigurohet një pasqyrë sa më e plotë e sektorit të tekstilit, praktikave të menaxhimit të mbeturinave dhe mundësive për zbatimin e ekonomisë qarkore. Rezultatet e raportit bazohen në të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2025 dhe, aty ku ka qenë metodologjikisht e mundur, janë krahasuar me gjetjet e vitit 2024 për të identifikuar ndryshimet dhe trendet kryesore.

REZULTATET E STUDIMIT

ANALIZA E POLITIKAVE

Në Kosovë ekzistojnë disa politika, strategji, marrëveshje dhe iniciativa që ndikojnë në menaxhimin e mbeturinave, ekonominë qarkore dhe sektorin e tekstilit:

- **Politika Industriale e Kosovës 2030** – Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, synon të mbështesë modernizimin industrial, rritjen e produktivitetit, integrimin në tregje ndërkombëtare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve prodhues.
- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030** – Vendos zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, rritjen e mirëqenies dhe forcimin e kapaciteteve institucionale si prioritet afatgjatë, duke krijuar bazë të përgjithshme për zhvillimin e sektorëve industrialë, përfshirë tekstilin.
- **Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 dhe ndryshimet përkatëse** – Përcakton parimet e përgjithshme për parandalimin, reduktimin, ripërdorimin dhe trajtimin e mbeturinave, por ende nuk krijon një regjim specifik për mbeturinat tekstile si fraksion i veçantë.
- **Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035 dhe Plan i Veprimit 2024–2026** – Përbëjnë zhvillim të rëndësishëm gjatë periudhës 2024–2025, duke orientuar Kosovën drejt përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave, ndarjes në burim, riciklimit, reduktimit të mbeturinave në deponi dhe përafrimit me standardet e BE-së.
- **Udhërrëfyesi i Kosovës për Ekonominë Qarkore** – Identifikon sektorët prioritarë për tranzicionin qarkor dhe krijon bazë strategjike për trajtimin e sektorit të tekstilit si pjesë e ekonomisë qarkore, edhe pse ende mungojnë instrumente konkrete sektoriale.
- **Ligji për Ndryshimet Klimatike Nr. 08/L-250** – I miratuar në vitin 2024, përfaqëson avancim të rëndësishëm në kornizën klimatike të vendit dhe vendos bazën për masa të zbutjes, përshtatjes, monitorimit dhe raportimit të ndikimeve klimatike.
- **Skemat mbështetëse të KIESA-s për bizneset prodhuese dhe përpunuese** – Në vitin 2025 kanë përfshirë elemente që lidhen me ekonominë qarkore dhe kriteret e gjelbra, duke treguar një lidhje më të qartë ndërmjet mbështetjes industriale dhe tranzicionit të gjelbër.

Sa i përket strategjive, nismave dhe zbatimit praktik:

- **Mbështetja institucionale për industrinë e tekstilit mbetet e kufizuar**
 - Gjetjet e studimit të USAID-it vazhdojnë të jenë relevante, pasi tregojnë se shumica e bizneseve nuk kanë raportuar mbështetje të qëndrueshme institucionale dhe se nevojat kryesore lidhen me punëtorë të kualifikuar, përditësim të teknologjisë dhe qasje më të mirë në financim.
- **Projekti “Shërbime të Qëndrueshme Komunale” i GIZ-it** – Ka kontribuar në përmirësimin e shërbimeve komunale të menaxhimit të mbeturinave, zgjerimin e mbulimit me shërbime dhe reduktimin e deponive ilegale, duke krijuar bazë për qasje më të strukturuar ndaj menaxhimit të mbeturinave.
- **Projekti SEREC** – Promovimi i ekonomisë qarkore si model i qëndrueshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale – Ka kontribuar në mbledhjen, ripërpunimin dhe ripërdorimin e materialeve, përfshirë tekstin, si dhe në nxitjen e sipërmarrjes sociale dhe punësimit për grupe të marginalizuara.
- **Nisma 3R Thrift Store** – Paraqet shembull praktik të aplikimit të ekonomisë qarkore në tekstil, përmes promovimit të veshjeve të dorës së dytë, zgjatjes së jetës së produkteve tekstile

dhe reduktimit të mbeturinave përmes ripërdorimit.

- **Rilindja Gjellbër dhe Circular Economy Awards 2025** – Vlerësimi i Rilindja Gjellbër për zhvillimin e qendrës së parë për riciklimin e tekstilit në Kosovë tregon se modelet praktike të ripërdorimit, riciklimit dhe ndërmarrësisë sociale kanë filluar të zhvillohen në nivel lokal.
- **Projekti “Circular Economy for Green Transition in Kosovo”** – I financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga People in Need në bashkëpunim me Rilindja Gjellbër, ka synuar avancimin e tranzicionit drejt ekonomisë qarkore në Kosovë, me fokus në fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjatë periudhës 2023–2025.
- **Projekti “Circular Urban Development – Kosovo4Green”** – I zbatuar nga GIZ në partneritet me MMPHI-në, ka filluar në vitin 2024 dhe synon përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm përmes qasjeve të ekonomisë qarkore deri në vitin 2028.

Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, mbeten sfida të rëndësishme strukturore dhe institucionale:

Zbatimi i Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkore mbetet i kufizuar.

Ndarja në burim dhe riciklimi nuk zbatohen ende në mënyrë sistematike..

Sistemi për Rimbursimin e Depozitave ende nuk është operacional.

Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë ka pësuar vonesa.

Ligji i ri për Mbeturina dhe mekanizmat e Përgjegjësisë së Zgjjeruar të Prodhuesit janë ende në proces dhe kërkojnë kapacitete më të mëdha institucionale, financiare dhe teknike për zbatim efektiv.

Sa i përket marrëveshjeve dhe standardeve ndërkombëtare:

- **Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në** – Mbetet kornizë e rëndësishme për përafrimin gradual të Kosovës me standardet evropiane, përfshirë fushat që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, qarkullimin e materialeve dhe performancën mjedisore të produkteve.
- **CEFTA dhe marrëveshjet rajonale** – Vazhdimisht ndikojnë në qarkullimin e produkteve të tekstilit, importin, eksportin dhe integrimin rajonal të sektorit, por nuk krijojnë në vetvete standarde të detyrueshme për menaxhimin e mbeturinave tekstile apo dizajnin qarkor.
- **Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor** – E vendos ekonominë qarkore në qendër të tranzicionit të gjelbër të rajonit dhe është relevante për sektorin e tekstilit për shkak të lidhjes së tij me konsumin intensiv të burimeve, gjenerimin e mbeturinave, ripërdorimin dhe riciklimin.
- **Marrëveshja e Tregtisë së Lirë Kosovë-EFTA** – E nënshkruar më 22 janar 2025, paraqet zhvillim të ri tregtar dhe mund të krijojë mundësi shtesë për integrimin e sektorit të tekstilit në tregje të reja, edhe pse nuk krijon detyrime të drejtpërdrejta për praktika qarkore.
- **Plani i Veprimit për Ekonominë Qarkore i BE-së** – Identifikon tekstilin si një nga zinxhirët kryesorë të produkteve me ndikim të lartë mjedisor dhe ekonomik, duke e lidhur sektorin

me nevojën për dizajn më të qëndrueshëm, ripërdorim, riciklim dhe reduktim të mbeturinave.

- **Strategjia e BE-së për Tekstil të Qëndrueshëm dhe Qarkor** – Përcakton drejtimin e politikave evropiane për tekstin, duke kërkuar produkte më të qëndrueshme, më të riparueshme, më të ripërdorshme dhe më të riciklueshme.
- **Direktiva Kornizë për Mbeturinat e BE-së, e ndryshuar përmes Direktivës (EU) 2018/851** – Kërkon që shtetet anëtare të BE-së të krijojnë sisteme të ndara për grumbullimin e tekstileve nga 1 janari 2025, duke e trajtuar tekstin si fraksion të veçantë që kërkon ndarje, grumbullim, ripërdorim dhe riciklim.
- **Rishikimi më i ri i Direktivës Kornizë për Mbeturinat** – Ka hyrë në fuqi në tetor 2025 dhe ka fokus të veçantë te mbeturinat ushqimore dhe tekstile, duke forcuar qasjen e BE-së drejt detyrimeve më konkrete për prodhuesit, importuesit dhe vendosësit e produkteve në treg.
- **Rregullorja e BE-së për Dërgesat e Mbeturinave** – Synon të rregullojë më mirë lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave dhe të kufizojë praktikën që zhvendosin barrën mjedisore jashtë BE-së. Për Kosovën, kjo e rrit rëndësinë e rishikimit të programeve nacionale për parandalimin e mbeturinave dhe trajtimin e importit të veshmbathjeve të përdorura.

Në përgjithësi, periudha 2024–2025 tregon **një avancim më të qartë** të kornizës strategjike, klimatike dhe evropiane për menaxhimin e mbeturinave dhe ekonominë qarkore. Megjithatë, Kosova **ende nuk ka një politikë të posaçme** për mbeturinat tekstile, **nuk ka sistem të ndarë** për grumbullimin e tekstileve, **nuk ka skemë funksionale PZP** për tekstin dhe **nuk ka statistika të dedikuara** për këtë fraksion. Për këtë arsye, sfida kryesore mbetet përkthimi i orientimeve strategjike dhe standardeve ndërkombëtare në politika, instrumente dhe investime konkrete për sektorin e tekstit.

PROFILI I INDUSTRIË SË TEKSTILIT

Sektori i tekstilit në Kosovë vazhdon të dominohet nga mikro-ndërmarrjet. Nga gjithsej 7,210 kompani të identifikuara, 98.6% janë mikro-ndërmarrje, 1.1% janë ndërmarrje të vogla, 0.2% janë ndërmarrje të mesme, ndërsa vetëm 0.1% janë ndërmarrje të mëdha. Krahësuar me vitin e kaluar, struktura mbetet pothuajse e njëjtë në thelb, pasi edhe atëherë sektori dominohej nga mikro-ndërmarrjet me 99.2%, çka tregon se zgjerimi i numrit të kompanive nuk është shoqëruar me një transformim të dukshëm në madhësinë e bizneseve.



Figura 1. Kategorizimi i bizneseve

Sektori vazhdon të dominohet nga tregtia, por me një peshë disi më të ulët se vitin e kaluar. Tregtia përfaqëson 71.0% të kompanive, prodhimi 25.3%, ndërsa shërbimet e pastrimit 3.7%. Krahësuar me vitin paraprak, kur tregtia zinte 77.3% dhe prodhimi vetëm 19.5%, vërehet një rritje e peshës së prodhimit dhe një ulje relative e dominimit të tregtisë. Kjo mund të nënkuptojë një pasqyrë më të plotë të sektorit në këtë version, por gjithashtu sugjeron se aktivitetet prodhuese kanë një rol më të madh sesa është reflektuar më herët.




Figura 2. Llojet e aktiviteteve të bizneseve

Në aspektin e punësimit, sektori i tekstilit përfshin gjithsej **13,897 punëtorë** të regjistruar, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak. Komunitet me pjesëmarrjen më të lartë të punëtorëve janë **Prishtina** me 27.6%, **Prizreni** me 11.6% dhe **Ferizaj** me 9.2%.

FURNIZIMI ME PRODUKTE TË TEKSTILIT

Krahas fuqisë punëtore dhe shpërndarjes së saj, një tjetër aspekt kyç për industrinë mbetet balanca tregtare e produkteve të tekstilit, e cila vazhdon të jetë dukshëm në favor të importit. Te veshmbathjet, **importi arrin në 14.71 milionë kg**, ndërsa **eksporti vetëm 0.52 milionë kg**. Te aksesoret, **importi është 2.16 milionë kg**, ndërsa **eksporti 0.03 milionë kg**. **Tekstili shtëpiak shënon 4.69 milionë kg import dhe 1.04 milionë kg eksport**. Këto të dhëna tregojnë se tregu vendor vazhdon të mbështetet kryesisht në mallra të importuara dhe se disbalanca tregtare mbetet e thellë.

Krahasuar me vitin paraprak, ndryshimet në tregtinë e tekstilit nuk janë të njëjta në vlerë dhe në sasi. Në disa kategori, sidomos te veshmbathjet, **vlera e tregtisë është rritur**, ndërsa **sasia fizike është më e ulët se në vitin 2024**. Kjo sugjeron se qarkullimi është ndikuar jo vetëm nga volumi i mallrave, por edhe nga **çmimet, struktura e produkteve dhe lloji i artikujve të tregtuar**.




Figura 3. Eksporti dhe importi i produkteve të tekstit sipas kategorive kryesore për vitin 2025

Të dhënat tregojnë se Kosova **ka importuar rreth 21.56 milionë kilogramë** produkte tekstili në vitin 2025, ndërsa **ka eksportuar vetëm rreth 1.59 milionë kilogramë**. Kjo rezulton në një tepëri prej rreth 19.97 milionë kilogramësh tekstil që mbeten brenda vendit, duke treguar një disbalancë të thellë në favor të importit

Pjesa kryesore e sasisë së importuar vazhdon të përqendrohet te veshmbathjet, të cilat përbëjnë rreth **63.9%** të totalit të importuar në këto kategori. Pas tyre renditet tekstili shtëpiak me **20.4%**, aksesorët me **9.4%** dhe veshjet e përdorura me **6.3%**. Ky fluks i madh tekstilësh që hyn dhe nuk del nga vendi mbetet një indikator i drejtpërdrejtë për sasinë potenciale të mbeturinave tekstile, sidomos në mungesë të sistemeve të konsoliduara për ripërdorim, grumbullim të ndarë dhe riciklim.

Nëse shihet veçmas kategoria e veshjeve të përdorura, disproporcioni mbetet shumë i fortë edhe në aspektin sasior. Gjatë vitit 2025 janë eksportuar vetëm 0.05 milionë kg, ndërsa janë importuar 1.45 milionë kg. Krahësuar me vitin 2024, importi i kësaj kategorie është rritur, ndërsa eksporti mbetet shumë i ulët. Kjo sugjeron se veshjet e përdorura vazhdojnë të hyjnë në tregun vendor në sasi të mëdha, pa u riintegruar në mënyrë të plotë në një cikël qarkor, çka rrit rrezikun që një pjesë e konsiderueshme e tyre të përfundojë si mbeturina.




Figura 4. Eksporti dhe importi i veshjeve të përdorura për vitin 2025

Kjo strukturë e sektorit dhe bilanci i thelluar tregtar ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si qytetarët furnizohen me produkte tekstili, siç do të shqyrtohet në pjesën në vijim.

Në aspektin e vlerës monetare, **peshën më të madhe e mbajnë veshmbathjet, me rreth 237.03 milionë euro import dhe 35.69 milionë euro eksport.** Edhe te aksesoret diferenca mbetet shumë e thellë, me 17.08 milionë euro import kundrejt vetëm 0.47 milionë euro eksport. Te tekstili shtëpiak tabloja është e njëjtë, pasi importi arrin në 24.01 milionë euro, ndërsa eksporti mbetet në 5.37 milionë euro. Krahësuar me vitin 2024, ndryshimi më i dukshëm është rritja e fortë e vlerës së importeve, veçanërisht te veshmbathjet, që sugjeron zgjerim të mëtijshëm të varësisë nga tregjet e jashtme.




Figura 5. Vlera e mallrave sipas kategorive për vitin 2025

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij studimi është mënyra se si qytetarët furnizohen me produkte të tekstilit. Edhe në vitin 2025, blerja personale mbetet forma dominuese e furnizimit me veshmbathje në pothuajse të gjitha kategoritë, duke u rritur te këpucët nga **87.6%** në **90.5%**, te bluzat/këmishat nga **86.0%** në **88.6%**, te xhaketat/palltot nga **80.8%** në **84.0%** dhe te produktet sportive nga **71.5%** në **74.0%**.

Megjithatë, përdorimi i formave alternative të furnizimit mbetet më i kufizuar. Blerjet nga familjarët kanë rënë në disa kategori bazë, si bluzat/këmishat nga **21.4%** në **15.1%**, ndërsa ripërdorimi nga anëtarët e familjes ka shënuar rënie në shumicën e kategorive, përfshirë xhaketat/palltot nga **18.5%** në **16.1%** dhe këpucët nga **11.2%** në **9.1%**. Kjo tregon se modeli i furnizimit mbetet kryesisht i orientuar drejt blerjes personale, ndërsa ripërdorimi familjar vazhdon të ketë rol të kufizuar.




Figura 6. Çfarë lloji të produkteve të mëposhtme të tekstilit blini - veshmbathje? (Pytje e shumëfishtë)

Rezultatet tregojnë se arsyet kryesore për mosblerjen e produkteve second-hand mbeten të lidhura kryesisht me higjienën, perceptimin personal dhe cilësinë. Shqetësimi se produktet e ripërdorura nuk janë të pastra apo higjienike është rritur nga **44.0%** në **50.7%**, duke mbetur arsyeja kryesore për shmangien e tyre. Mospëlqimi ndaj idesë së përdorimit të diçkaje të përdorur nga dikush tjetër mbetet gjithashtu i lartë, por pothuajse i pandryshuar, nga **43.6%** në **42.5%**.




Figura 7. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? (Pytje e shumëfishtë)

Krahasuar me vitin paraprak, rritja më e dukshme vërehet te shqetësimet për cilësinë, të cilat janë rritur nga **23.7%** në **33.0%**, si dhe te vështirësia për të gjetur produkte të përshtatshme, nga **25.3%** në **29.1%**. Kjo tregon se rezistenca ndaj produkteve të përdorura nuk lidhet vetëm me stigma apo preferenca personale, por edhe me mungesë besimi në pastërti, cilësi dhe përshtatshmëri. Për këtë arsye, rritja e pranimi të produkteve second-hand kërkon jo vetëm ndërgjegjësim mjedisor, por edhe garanci më të qarta për selektimin, higjienën dhe cilësinë e tyre.




Figura 8. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? Krahasimi 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë)

Kuptimi i materialeve që përdoren në produktet e tekstilit është i rëndësishëm për të vlerësuar edhe ndikimin e tyre të mundshëm mjedisor. Rezultatet tregojnë se pambuku vazhdon të jetë materiali më i përdorur në produktet e prodhuara, i raportuar në **38.5%** të rasteve, bazuar në përgjigjet e vlefshme të bizneseve prodhuese (**N=13**). Megjithatë, kjo përqindje është dukshëm më e ulët krahasuar me vitin paraprak, kur pambuku ishte raportuar në **63.3%** të rasteve. Pëlhura tekstile përbën **23.1%**, ndërsa lëkura natyrale dhe materialet sintetike raportohen secila me nga **15.4%**. Poliesteri paraqitet më rrallë, me **7.7%**. Nga aspekti mjedisor, përdorimi i pambikut dhe lëkurës natyrale mund të lidhet me më pak mbetje jo-biodegraduese, ndërsa prania e materialeve sintetike dhe poliesterit, edhe pse më e kufizuar, vazhdon të paraqesë sfida për shkak të qëndrueshmërisë së tyre më të lartë dhe vështirësisë së trajtimit pas përdorimit.




Figura 9. Cila është lënda e parë që përdorni për produktet e prodhuara? (Pyetje e shumëfishtë)

Pambuku mbetet materiali më i kërkuar nga klientët, me **60.6%**, pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraprak (**61.0%**). Poliesteri vazhdon të përdoret gjerësisht, por ka rënë lehtë nga **46.0%** në **42.4%**, ndërsa materialet sintetike janë ulur nga **28.0%** në **22.2%**. Ndërkohë, përdorimi i pëlhurës së lirit (**29.3%**) dhe materialeve të thurura (**20.2%**) tregon një gamë më të gjerë materialesh, ndërsa kategoria “tjetër” (**29.3%**) sugjeron fleksibilitet më të madh në furnizim, përfshirë raste kur materialet sigurohen nga vetë klientët.

MENAXHIMI I MBETURINAVE TË TEKSTILIT

Menaxhimi i tekstileve që nuk përdoren më nga qytetarët në Kosovë vazhdon të mbështetet kryesisht në praktika tradicionale si dhurimi dhe ruajtja për ripërdorim. Për veshmbathjet dhe aksesoret, qytetarët më së shpeshti i dhurojnë te familjarët ose miqtë (**58.3%**) dhe te familjet në nevojë (**41.4%**), ndërsa **16.6%** i hedhin si mbeturina. Për tekstilin shtëpiak, praktika kryesore mbetet dhurimi te familjarët (**49.6%**), pasuar nga dhurimi për familje në nevojë (**27.2%**) dhe ruajtja për ripërdorim (**25.5%**), ndërsa hedhja si mbeturinë ka rënë në **22.8%**.




Figura 10. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesorët/produktet e tekstit shtëpiak që nuk i përdorni më? (Pyetje e shumëfishtë)

Në lidhje me sasinë e veshmbathjeve që hidhen gjatë një viti, të dhënat e vitit 2025 tregojnë raportim më të shpërndarë dhe përgjithësisht në kategori më të ulëta peshe. Përgjigjet për **1–2 kg** dhe **3–5 kg** përbëjnë së bashku **35.0%**, ndërsa kategoritë mbi **10 kg** mbeten më të kufizuara. Krahasuar me vitin paraprak, kur **44.7%** raportonin **1–5 kg** dhe **21.8%** raportonin **11–15 kg**, duket se sasia e deklaruar është më e ulët. Megjithatë, rritja e përgjigjeve “nuk e di” nga **8.6%** në **31.4%** tregon pasiguri më të madhe në vlerësimin e sasisë së mbeturinave tekstile.




Figura 11. Përafërsisht sa kilogram veshmbathje i hidhni gjatë një viti?

Bazuar në këto të dhëna, është kryer një kalkulim për të vlerësuar sasinë e mbeturinave tekstile të gjeneruara nga qytetarët. Nga të anketuarit, 16.6% deklaruan se hedhin veshmbathje në mbeturina, duke raportuar një total prej 485 kg në vit. Kjo i korrespondon një mesatareje prej rreth 9.70 kg për person në vit brenda këtij grupi. Duke e aplikuar këtë mesatare mbi popullsinë që përfaqëson këtë sjellje, vlerësohet që **qytetarët në Kosovë gjenerojnë afërsisht 2,695.68 ton mbeturina tekstili në vit nga veshmbathjet.**

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky është një **vlerësim i përafërt** dhe jo një shifër zyrtare, për shkak të mungesës së të dhënave reale dhe të strukturuar për nivelin kombëtar.

Përveç qytetarëve, një rol të rëndësishëm në gjenerimin e mbetjeve të tekstilit luajnë edhe bizneset. Mënyra si kompanitë menaxhojnë mbeturinat e tyre është kyçe për të vlerësuar ndikimin mjedisor dhe potencialin për ripërdorim dhe riciklim. Në vazhdim analizohen praktikatat aktuale dhe hapësirat për përmirësim në këtë drejtim.

Të dhënat tregojnë se në vitin 2025 kompanitë janë mbështetur më shumë në deponitë komunale për menaxhimin e mbeturinave të materialeve, me 70.0% krahasuar me 61.0% në vitin 2024. Ndërkohë, praktikatat më të lidhura me ekonominë qarkore kanë shënuar rënie: përdorimi i materialeve të mbetura ka rënë nga 37.0% në 15.0%, bashkëpunimi me iniciativë për rishfrytëzim nga 10.0% në 4.0%, ndërsa riciklimi nga 6.0% në 4.0%. Kjo mund të lidhet edhe me profilin e kompanive të anketuara, ku këtë vit dominojnë më shumë aktivitetet e shitjes me pakicë dhe më pak prodhimi, ripërpunimi apo riparimi. Si rezultat, më pak kompani duket se kanë procese të brendshme për rikthimin e materialeve në përdorim. Në tërësi, krahasimi tregon një zhvendosje nga praktikatat qarkore drejt menaxhimit më tradicional të mbeturinave, duke theksuar nevojën për mbështetje praktike, lidhje me kompani riciklimi dhe mekanizma më të zbatueshëm për ripërdorim.




Figura 12. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? (Pytje e shumëfishtë)

Krahasimi 2024–2025 tregon se menaxhimi i mbeturinave nga bizneset është zhvendosur më shumë drejt deponimit komunal, ndërsa praktikat më qarkore kanë shënuar rënie. Përdorimi i materialeve të mbetura, bashkëpunimi për rishfrytëzim dhe riciklimi janë më pak të pranishme se vitin e kaluar, çka sugjeron dobësim të praktikave të brendshme të ripërdorimit. Kjo mund të lidhet edhe me profilin e bizneseve të anketuara këtë vit, ku aktivitetet duken më të orientuara drejt shitjes sesa prodhimit apo ripërpunimit. Në tërësi, të dhënat theksojnë nevojën për mekanizma më praktikë që e bëjnë ripërdorimin dhe riciklimin më të zbatueshëm për bizneset.




Figura 13. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? Krahasimi 2024–2025 (Pytje e shumëfishtë)

Lloji më i zakonshëm i mbeturinave të gjeneruara janë mbeturinat tekstile, të raportuara nga 49.0% e bizneseve, pasuar nga letra/kartoni (28.0%) dhe plastika (24.0%). Kjo tregon se, krahas mbetjeve nga materiali tekstil, edhe materialet ndihmëse dhe ambalazhuese zënë një pjesë të rëndësishme në strukturën e mbeturinave. Kategoritë e tjera janë më pak të përhapura, ndërsa 16.0% kanë zgjedhur “Tjetër”, kryesisht duke deklaruar se nuk gjenerojnë mbeturina. Në përgjithësi, mbeturinat e tekstilit mbeten kategoria dominuese, ndërsa materialet e ambalazhimit paraqiten si burim dytësor i mbeturinave.




Figura 14. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës?

Në vitin 2025, profili i mbeturinave është më i shpërndarë dhe duket më i lidhur me aktivitete të shitjes, paketimit dhe qarkullimit të produkteve. Edhe pse mbetjet tekstile mbeten kategoria kryesore, rënia nga 73.0% në 49.0% sugjeron më pak mbetje të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin apo përpunimin. Ndërkohë, rritja e letrës/kartonit dhe plastikës tregon praninë më të madhe të materialeve ambalazhuese. Prandaj, ndryshimi reflekton jo vetëm ulje të mbetjeve tekstile, por edhe një profil më tregtar të kompanive të anketuara.




Figura 15. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës? Krahاسimi 2024–2025

Rreth 9% e kompanive nuk kanë njohuri se sa mbeturina tekstili gjenerojnë në vit, duke sugjeruar mungesë të matjes apo monitorimit. Shumica (69%) raportojnë se nuk gjenerojnë fare mbeturina tekstili, ndërsa vetëm rreth 22% kanë deklaruar sasi pozitive. Te këto kompani, gjenerimi mbetet kryesisht nën 1 ton në vit, me pak raste mbi 1 ton dhe vetëm raste të izoluar mbi 50 ton. Në total, volumi i mbeturinave duket i përqendruar te një numër i vogël kompanish me nivele më të larta prodhimi.

Nga këto të dhëna për sektorin e bizneseve të tekstilit kemi kalkuluar në mënyrë të përafërt gjenerimi i përgjithshëm i mbeturinave të tekstilit. Duke përdorur mesataret e deklaruara të gjenerimit të mbeturinave sipas kategorive kryesore të aktivitetit dhe duke i shkallëzuar ato me shpërndarjen aktuale të bizneseve aktive në Kosovë, **vlërësohet se sektori gjeneron rreth 10,338.62 ton mbeturina tekstili në vit.**

Ky kalkulim përfaqëson një **vlërësim indikativ**, duke qenë se mungojnë të dhëna sistematike dhe zyrtare mbi menaxhimin e mbetjeve tekstile në sektorin privat në Kosovë.

Këto të dhëna të thelluara për qytetarët dhe bizneset shërbejnë si bazë për të vlerësuar edhe njohuritë dhe ndërgjegjësimin mbi ndikimin mjedisor të këtij sektori.

NJOHURITË DHE NDËRGJEGJËSIMI

Me rritjen e vetëdijes për ndikimin mjedisor të industrisë së tekstilit, ky seksion shqyrton sa dhe si qytetarët angazhohen në ripërdorimin dhe riciklimin e produkteve të tekstilit. Rezultatet ndihmojnë në kuptimin e nivelit të ndërgjegjësimit dhe barrierave kryesore që ndikojnë në këto praktika.

Në matjen më të fundit, 50.8% deklarojnë se kanë njohuri për këtë ndikim, krahasuar me 53.9% në 2024. Paralelisht, përqindja e atyre që shprehen se nuk kanë njohuri është rritur lehtë, nga 46.1% në 49.2%.

Këto gjetje tregojnë se niveli i vetëdijes mjedisore lidhur me tekstilin mbetet relativisht i balancuar, pa ndryshime të theksuara ndërmjet dy periudhave të matjes. Përqindja e lartë e respondentëve që nuk

kanë njohuri mbi këtë çështje tregon nevojën për ndërhyrje më të strukturuar informuese dhe edukative, veçanërisht në lidhje me ndikimin e prodhimit, konsumit të shpejtë, asgjësimit dhe mundësive për ripërdorim e riciklim të produkteve të tekstilit.

Në të dyja matjet, mungesa e informacionit në media mbetet arsyeja kryesore e mosinformimit, edhe pse ka rënë lehtë nga 66.2% në 62.5%. Ndërkohë, mungesa e fushatave ndërgjegjëse është rritur nga 32.4% në 36.0%, ndërsa mungesa e interesit personal mbetet pothuajse e pandryshuar. Rritje vërehet edhe te ata që nuk e shohin çështjen si problem të rëndësishëm, nga 9.7% në 14.9%, duke sugjeruar nevojë për komunikim më të qartë publik mbi rëndësinë e temës..




Figura 16. Cili mendoni se është shkaku kryesor i mos informimit tuaj mbi këtë çështje? (Pytje e shumëfishtë)

ZBATIMI I EKONOMISË QARKORE

Zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkore në industrinë e tekstilit në Kosovë mbetet ende në faza të hershme dhe i fragmentuar. Sipas intervistave me politikbërës, tekstili ende nuk trajtohet si fraksion i veçantë në praktikë, pasi mungon ndarja në burim, infrastruktura e trajtimit dhe një sistem i qëndrueshëm për grumbullim e riciklim. Megjithatë, është shënuar një zhvillim pozitiv në nivel ligjor, pasi Ligji i ri për Mbeturinat, i cili është në proces hartimi, pritet ta përfshijë tekstilin si kategori specifike. Kjo tregon se sektori po fillon të njihet më qartë në politikat e mbeturinave, por zbatimi praktik ende varet nga financimi, kapacitetet institucionale dhe ndërtimi i një zinxhiri funksional për ndarje, grumbullim, transport dhe trajtim.

Njohuria për ekonominë qarkore mbetet e kufizuar, por me përmirësim modest. Në matjen e fundit, 12.7% deklarojnë se e njohin shumë mirë konceptin, krahasuar me 5.6% më parë. Ndërkohë, pjesa që nuk e njeh konceptin mbetet shumicë, por ka rënë nga 56.0% në 51.9%. Kjo tregon rritje të lehtë të vetëdijes, por edhe nevojë të vazhdueshme për informim më të qartë mbi ekonominë qarkore.




Figura 17. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore?

Krahasimi me vitin 2024 tregon një përmirësim të lehtë në njohjen e ekonomisë qarkore, por jo ende ndryshim të thellë në informim. Rënia e atyre që nuk e njohin konceptin nga 56.0% në 51.9%, dhe rritja e atyre që e njohin shumë mirë nga 5.6% në 12.7%, tregojnë lëvizje pozitive. Megjithatë, më shumë se gjysma ende nuk e njohin konceptin, ndërsa një pjesë tjetër ka vetëm njohuri sipërfaqësore. Kjo sugjeron nevojën për informim më praktik, të lidhur me shembuj konkretë të riciklimit, ripërdorimit dhe konsumit të përditshëm.




Figura 18. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore? Krahاسimi 2024–2025

Edhe në mesin e bizneseve, njohja për ekonominë qarkore mbetet e ulët: **81.0% nuk kanë dëgjuar për këtë koncept, ndërsa vetëm 19.0% deklarojnë se janë të njohura me të.** Megjithatë, ndër kompanitë që kanë dëgjuar për ekonominë qarkore, shumica shprehin interes për zbatim në praktikë, me 63.2% që deklarojnë gatishmëri për aplikimin e parimeve të saj. Kjo tregon se pengesa kryesore nuk lidhet domosdoshmërisht me mungesën e interesimit, por me mungesën e informimit dhe udhëzimeve praktike për bizneset.

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE GJURMA E KARBONIT

Krahas konceptit të ekonomisë qarkore, çështja e ndikimit klimatik ka marrë vëmendje në rritje nga ana e bizneseve. Krahasuar me vitin 2024, shqetësimi i kompanive për ndikimin mjedisor është përmirësuar lehtë, me rritje të atyre që janë “të shqetësuar” nga 20.0% në 27.0% dhe rënie të atyre “aspak të shqetësuar” nga 22.0% në 15.0%. Megjithatë, gatishmëria për të investuar në praktika që reduktojnë ndikimin mjedisor dhe gjurmën e karbonit ka rënë ndjeshëm, nga 70.0% në 27.0%. Kjo tregon se vetëdija mjedisore është rritur pak, por nuk është përkthyer në gatishmëri konkrete për investim, duke sugjeruar nevojë për stimuj financiarë, mbështetje praktike dhe informim më të qartë për bizneset.

INTERESIMI DHE SFIDAT PËR RICIKLIM DHE RIPËRDORIM

Një komponent kyç në përmbushjen e objektivave për qëndrueshmëri është përfshirja aktive në praktikën e riciklimit dhe ripërdorimit. Përfshirja e kompanive në iniciativën të ripërdorimit dhe riciklimit mbetet e ulët, me vetëm 5.0% që deklarojnë se janë aktualisht të angazhuara, ndërsa

64.0% nuk janë të përfshira dhe 31.0% nuk janë të sigurta. Krahësuar me vitin 2024, pengesat paraqiten më të shpërndara, nga mungesa e informacionit drejt pasigurisë, mungesës së njohurive dhe perceptimit se nuk ka nevojë për përfshirje. Kjo tregon se kompanitë kanë nevojë jo vetëm për informim të përgjithshëm, por për udhëzime praktike, shembuj të zbatueshëm dhe zgjidhje të përshtatura për biznese me kapacitete dhe sasi të ndryshme mbeturinash.




Figura 19. Nëse jo, pse nuk jeni të përfshirë?

Bashkëpunimi me kompani riciklimi mbetet shumë i kufizuar, me vetëm 4.0% të kompanive që raportojnë bashkëpunim aktiv, ndërsa 79.0% nuk bashkëpunojnë me kompani të tilla. Krahësuar me vitin paraprak, mungesa e informacionit ka rënë, por është rritur pjesa e kompanive që nuk janë të angazhuara, çka sugjeron se problemi lidhet më shumë me mungesën e lidhjeve funksionale dhe zgjidhjeve praktike në treg. Edhe interesi për bashkëpunim ka rënë nga 67.0% në 41.0%, duke treguar nevojën për oferta më të qarta, stimuj dhe mekanizma që e bëjnë bashkëpunimin me riciklues më të lehtë për bizneset.




Figura 20. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve?

Në vitin 2025, interesi i kompanive për bashkëpunim me kompani riciklimi ka rënë ndjeshëm krahasuar me vitin paraprak. Interesi pozitiv ka zbritur nga 67.0% në 41.0%, ndërsa kompanitë që nuk janë të interesuara janë rritur nga 17.0% në 46.0%. Kjo sugjeron se për rritjen e bashkëpunimit nuk mjafton vetëm informimi, por nevojiten modele më të qarta, më të përballueshme dhe praktikisht të zbatueshme për bizneset.




Figura 21. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve? Krahasimi 2024–2025

Krahasuar me vitin e kaluar, struktura e pengesave për bashkëpunim me kompani riciklimi ka ndryshuar ndjeshëm. Ndërsa më parë pengesa kryesore ishte mungesa e informacionit (77.0%), këtë vit dominon qartë faktori financiar, ku 70.0% e kompanive identifikojnë kostot e papërballueshme si barrierën kryesore. Në të njëjtën kohë, mungesa e informacionit ka rënë në 39.0%, duke sugjeruar një përmirësim të pjesshëm në aksesin ose ndërgjegjësimin për

shërbimet e riciklimit. Sfidat logjistike kanë pësuar një rritje relative, nga 8.0% në 15.0%, duke treguar se aspektet operationale po bëhen më të dukshme si pengesë në praktikë.




Figura 22. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit.

Në vitin 2025, pengesat për bashkëpunim me kompani riciklimi kanë ndryshuar ndjeshëm. Mungesa e informacionit ka rënë nga 77.0% në 39.0%, ndërsa kostot e papërballueshme janë rritur nga 17.0% në 70.0%, duke u bërë pengesa kryesore. Kjo sugjeron se kompanitë janë më të vetëdijshme për opsionet e riciklimit, por përballen më shumë me kufizime financiare dhe praktike për t'i zbatuar ato.




Figura 23. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit. Krahassimi 2024–2025

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Industria e tekstit në Kosovë mbetet një komponent i rëndësishëm i ekonomisë vendore, për shkak të numrit të bizneseve aktive, kapaciteteve për punësim dhe potencialit për zhvillim. Megjithatë, rezultatet e këtij vlerësimi tregojnë se sektori vazhdon të jetë i orientuar kryesisht drejt tregtisë dhe importit, ndërsa kalimi drejt një modeli më të qëndrueshëm dhe qarkor mbetet ende i kufizuar.

Bazuar në të dhënat e mbledhura përmes anketave me qytetarë, intervistave me biznese dhe intervistave me politikëbërës, gjetjet tregojnë se sfidat kryesore lidhen me mungesën e një sistemi të specializuar për menaxhimin e mbeturinave të tekstit, mungesën e ndarjes në burim, bashkëpunimin e kufizuar me ricikluesit dhe nivelin ende të ulët të njohurive për ekonominë qarkore.

Nga aspekti ekonomik, sektori dominohet nga mikro-ndërmarrjet dhe aktivitetet tregtare, veçanërisht tregtia me pakicë e tekstit dhe veshjeve. Edhe pse gjatë vitit 2025 është shënuar rritje në numrin e bizneseve dhe të punëtorëve krahasuar me vitin paraprak, kjo rritje nuk është shoqëruar me transformim të dukshëm strukturor drejt prodhimit, ripërpunimit apo modeleve më të qëndrueshme të biznesit. Në këtë kuptim, sektori mbetet ekonomikisht aktiv, por ende i brishtë në raport me kapacitetet për ekonomi qarkore.

Të dhënat tregojnë se Kosova vazhdon të ketë varësi të lartë nga importi i produkteve të tekstit. Importet janë dukshëm më të larta se eksportet në të gjitha kategoritë kryesore, përfshirë veshmbathjet, aksesoret dhe tekstin shtëpiak. Ky hendek është i rëndësishëm sepse një pjesë e madhe e tekstit që hyn në tregun vendor mbetet përfundimisht për t'u menaxhuar brenda Kosovës. Prandaj, bilanci negativ tregtar nuk paraqet vetëm sfidë ekonomike, por edhe presion të drejtpërdrejtë mbi sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Bazuar në kalkulimet e realizuara për qytetarët dhe bizneset, **vlerësohet se në Kosovë gjenerohen afërsisht 13,034.30 ton mbeturina tekstili në vit.** Nga kjo sasi, rreth 2,695.68 ton vijnë nga veshmbathjet e hedhura nga qytetarët, ndërsa rreth 10,338.62 ton vlerësohet të gjenerohen nga sektori i bizneseve të tekstit. Ky vlerësim mbetet i përafërt, për shkak të mungesës së statistikave zyrtare të ndara për mbeturinat tekstile, por tregon qartë përmasën e problemit dhe nevojën për sistem më të strukturuar të matjes, grumbullimit dhe trajtimit të tekstit.

Sa i përket qytetarëve, rezultatet tregojnë se praktikatat e konsumit dhe menaxhimit të tekstit ende nuk janë të orientuara mjaftueshëm drejt ripërdorimit dhe riciklimit. Një pjesë e qytetarëve vazhdojnë t'i hedhin produktet e tekstit si mbeturina, ndërsa njohuritë për ndikimin

mjedisor, ekonominë qarkore dhe mundësitë për riciklim mbeten të kufizuara. Megjithatë, ekziston hapësirë për ndryshim, sidomos nëse qytetarëve u ofrohet më shumë informacion praktik, pika të qarta grumbullimi dhe mundësi më të lehta për dhurim, ripërdorim dhe riciklim.

Nga ana e bizneseve, gjetjet tregojnë se praktikrat e ekonomisë qarkore mbeten të kufizuara. Kompanitë mbështeten kryesisht në deponitë komunale për menaxhimin e mbeturinave, ndërsa përdorimi i materialeve të mbetura, bashkëpunimi me iniciativë për rishfrytëzim dhe riciklimi kanë shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak. Bashkëpunimi aktiv me kompani riciklimi mbetet shumë i ulët, ndërsa pengesat kryesore lidhen me kostot, mungesën e lidhjeve funksionale me ricikluesit dhe mungesën e mekanizmave praktikë për përfshirje.

Një sfidë tjetër e rëndësishme është mungesa e matjes dhe monitorimit të mbeturinave të gjeneruara nga bizneset. Një pjesë e madhe e kompanive raportojnë se nuk gjenerojnë mbeturina tekstili ose nuk kanë njohuri të qarta për sasinë e gjeneruar, gjë që e vështirëson planifikimin e politikave dhe ndërhyrjeve të duhura. Në rastet kur raportohen mbeturina, ato janë shpesh të përqendruara te një numër më i vogël kompanish me aktivitet më të lartë prodhues.

Intervistat me politikëbërës dhe institucione tregojnë se Kosova ende nuk ka një sistem funksional kombëtar për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit si fraksion i veçantë. Tekstili nuk ndahet në burim, nuk ka statistika të dedikuara për sasinë që përfundon në deponi dhe nuk ekziston një zinxhir i plotë për grumbullim, transport, trajtim dhe riciklim. Edhe pse ka zhvillime pozitive në nivel strategjik dhe ligjor, përfshirë diskutimet për përfshirjen e tekstilit në Ligjin e ri për Mbeturinat, zbatimi praktik mbetet ende prapa dokumenteve strategjike.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se industria e tekstilit në Kosovë ka potencial për zhvillim të qëndrueshëm, por aktualisht ekzistojnë boshllëqe serioze në infrastrukturë, politika, financim, të dhëna, vetëdije dhe bashkëpunim ndërmjet aktorëve. Për të kaluar nga modeli linear drejt ekonomisë qarkore, nuk mjafton vetëm rritja e vetëdijes. Nevojitet një qasje e integruar që përfshin politika të dedikuara, investime në infrastrukturë, mbështetje për bizneset, edukim publik dhe krijim të partneriteteve funksionale ndërmjet institucioneve, komunave, bizneseve, organizatave dhe ricikluesve.

Për institucionet publike:

- Të zhvillohet një qasje e dedikuar për mbeturinat e tekstilit brenda kornizës së përgjithshme të menaxhimit të mbeturinave.
- Të njihet formalisht tekstili si fraksion specifik i mbeturinave, me objektiva të qarta për ndarje në burim, grumbullim të veçantë dhe trajtim të specializuar.
- Të integrohet tekstili në planet kombëtare dhe komunale të menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që të mos mbetet i padukshëm në statistika dhe i patrajtuar në praktikë.

- Të harmonizohen gradualisht politikat për tekstilin me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në raport me grumbullimin e ndarë, Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit dhe trajtimin e tekstilit si fraksion i veçantë.
- Të krijohet bazë më e qartë për financimin, organizimin dhe monitorimin e riciklimit të tekstilit.
- Të forcohet koordinimi ndërmjet ministrive, komunave, agjencive mjedisore, operatorëve të mbeturinave dhe sektorit privat.

Për MMPHI-NË, Doganën e Kosovës dhe Institucionet Tregtare:

- Të shqyrtohen masa më të rrepta për importin e veshmbathjeve të përdorura, sidomos për cilësinë, gjendjen dhe destinimin e tyre.
- Të kufizohet hyrja e kategorive të tekstilit që nuk janë të përshtatshme për ripërdorim real dhe që kanë jetëgjatësi shumë të shkurtër.
- Të forcohet monitorimi i materialeve që mund të përfundojnë shpejt si mbetura dhe të rrisin presionin mbi sistemin vendor të menaxhimit të mbeturinave.

Për Komunat, Operatorët e Mbeturinave dhe Ndërmarrjet e Riciklimit:

- Të forcohen kapacitetet operative për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit.
- Të krijohen pika të dedikuara për grumbullim të ndarë të tekstilit në nivel lokal.
- Të zhvillohen modele pilot për selektim, grumbullim, ripërdorim dhe riciklim të tekstilit.
- Të ndërtohen partneritete funksionale ndërmjet komunave, operatorëve të mbeturinave, organizatave komunitare dhe ndërmarrjeve që merren me ripërdorim ose riciklim.
- Të sigurohet që politikat për tekstilin të shoqërohen me investime konkrete në infrastrukturë dhe kapacitete operative.

Për Institucionet që Mbështesin Sektorin Privat:

- Të krijohen stimuj financiarë dhe teknikë për bizneset që adoptojnë praktika të ekonomisë qarkore.
- Të ofrohen grante për pajisje dhe teknologji që ndihmojnë në reduktimin dhe trajtimin e mbeturinave të tekstilit.
- Të mbështetet ripërdorimi i materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit.
- Të krijohen skema të posaçme për bizneset që kalojnë nga modeli linear në modele më qarkore.
- Të sigurohet që mbështetja të jetë e arritshme edhe për mikro-ndërmarrjet dhe bizneset e vogla.
- Të lidhen skemat mbështetëse me kritere të gjelbra, si reduktimi i mbeturinave, dizajni qarkor, përdorimi efikas i materialeve dhe zgjatja e jetës së produktit.

Për Institucionet Statistikore dhe Mjedisore:

- Të përmirësohet sistemi i të dhënave për sektorin e tekstilit dhe mbeturinat e tekstilit.

- Të zhvillohen mekanizma për mbledhjen e të dhënave të ndara për importin, eksportin, gjenerimin, grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e tekstilit.
- Të krijohen tregues të qartë për matjen e progresit në menaxhimin e mbeturinave të tekstilit dhe zbatimin e ekonomisë qarkore.
- Të adresohet mungesa aktuale e statistikave për fraksionin tekstil, pasi kjo e vështirëson planifikimin dhe monitorimin e politikave.

Për Institucionet Edukative, Shkollat dhe Mediat:

- Të rritet ndërgjegjësimi publik për konsum të qëndrueshëm, ripërdorim, ndarje në burim dhe riciklim të tekstilit.
- Të zhvillohen aktivitete informuese për qytetarët, bizneset, komunat dhe institucionet arsimore.
- Të përfshihet ekonomia qarkore në aktivitete edukative, me fokus praktik në furnizimin, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve të tekstilit.
- Të promovohet ndryshimi i sjelljes së qytetarëve dhe bizneseve përmes shembujve konkretë dhe të zbatueshëm.

Për Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Joqeveritare:

- Të zhvillohen fushata vetëdijesimi për ndikimin mjedisor të tekstilit dhe mundësitë për ripërdorim e riciklim.
- Të krijohen iniciativa komunitare për grumbullim, dhurim, ripërdorim dhe riciklim të tekstilit.
- Të ndërtohen partneritete me komunat, shkollat, bizneset dhe ndërmarrjet e riciklimit për zbatimin e modeleve pilot.
- Të ndërmerren hulumtime të vazhdueshme dhe të publikohen informata praktike për aplikimin e ekonomisë qarkore në sektorin e tekstilit.

Për Donatorët dhe Partnerët Zhvillimorë:

- Të mbështeten me grante ose kredi të favorshme kompanitë që investojnë në riciklim, upcycling, ripërdorim apo prodhim të qëndrueshëm.
- Të financohen programe për zhvillimin e zinxhirit të riciklimit dhe ndërtimin e infrastrukturës për ndarje dhe grumbullim të tekstilit.
- Të mbështeten komunat dhe organizatat lokale në zhvillimin e modeleve pilot për tekstilin si fraksion i veçantë.
- Të ofrohet mbështetje teknike dhe financiare për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Për investitorët dhe Sektorin Privat:

- Të investohet në teknologji për riciklim, përpunim dhe ripërdorim të tekstilit.
- Të mbështetet zhvillimi i ndërmarrjeve të reja që fokusohen në dizajn të qëndrueshëm, riparim, upcycling dhe produkte të ricikluara.

- Të krijohen partneritete me biznese vendore, komuna dhe organizata komunitare për qendra të dedikuara të grumbullimit dhe përpunimit të tekstit.
- Të shfrytëzohen skemat e bashkëfinancimit nga BE-ja, donatorët ndërkombëtarë dhe institucionet vendore.
- Të mbështetet certifikimi dhe standardizimi i produkteve të ricikluara për qasje më të lehtë në tregjet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

Për Sektorin e Tekstit si Fushë Pilot për Ekonominë Qarkore:

- Të përdoret sektori i tekstit si fushë pilot për zbatimin praktik të ekonomisë qarkore.
- Të testohen modele të reja për grumbullim, ripërdorim, riciklim, sipërmarrje sociale dhe bashkëpunim publik-privat.
- Të trajtohet tekstili si sektor prioritar për ndërhyrje qarkore, duke marrë parasysh peshën ekonomike, varësinë nga importi dhe potencialin për gjenerim të mbeturinave.
- Të synohet jo vetëm reduktimi i ndikimit mjedisor, por edhe krijimi i vlerës së shtuar ekonomike dhe vendeve të reja të punës në sektorë të gjelbër.

Krahasimi me rekomandimet e raportit paraprak tregon se gjatë periudhës 2024–2025 ka pasur disa zhvillime në nivel strategjik dhe institucional, por zbatimi praktik në sektorin e tekstit mbetet i kufizuar. Në nivel të politikave publike, progresi lidhet kryesisht me avancimin e kornizës për menaxhimin e integruar të mbeturinave, diskutimet për Ligjin e ri për Mbeturina dhe trajtimin e mundshëm të tekstit si kategori specifike. Megjithatë, deri në periudhën e raportimit, ende nuk ekziston një sistem funksional për grumbullim të ndarë, riciklim të tekstit ose zbatim të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit për këtë sektor.

Në nivel të bizneseve, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se rekomandimet për matjen e mbeturinave, ripërdorimin e materialeve, ndarjen sipas llojit dhe bashkëpunimin me ricikluesit nuk janë zbatuar në shkallë të gjerë. Përkundrazi, kompanitë mbështeten më shumë në deponitë komunale se vitin e kaluar, ndërsa përdorimi i materialeve të mbetura, bashkëpunimi me iniciativë për rishfrytëzim dhe riciklimi kanë shënuar rënie. Po ashtu, bashkëpunimi aktiv me kompani riciklimi mbetet shumë i ulët, ndërsa gatishmëria për investime mjedisore është më e dobët se në vitin paraprak.

Në aspektin e ndërgjegjësimit, rezultatet tregojnë nevojë të vazhdueshme për informim më të strukturuar. Njohuria për ekonominë qarkore është përmirësuar lehtë te qytetarët, por mbetet e kufizuar për një pjesë të madhe të respondentëve dhe veçanërisht te bizneset. Kjo tregon se rekomandimet për fushata vetëdijësimi, edukim dhe shpërndarje të informacionit praktik janë ende të pazbatuara në shkallën e nevojshme.

Në përgjithësi, rekomandimet e raportit paraprak mbeten të vlefshme, por progresi gjatë vitit ka qenë më i dukshëm në nivel dokumentesh dhe orientimi strategjik sesa në zbatim praktik. Për fazën e ardhshme, nevojitet kalim më i qartë nga planifikimi drejt masave konkrete, me përgjegjësi të ndara për institucionet publike, komunat, bizneset, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe investitorët.

